



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit / Kancelarija Glavnog Drzavnog Tuzioca / Office  
of the Chief State Prosecutor

AD.nr. 03/2024  
Dt. 01 korrik 2024  
Prishtinë

Në kuptim të nenit 9 par.1,nënpar.1.4 lidhur me par. 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (Ligji.nr.06/L-057), në lidhje me ankesën e karakterit disiplinor të palës: [REDACTED] të datës 18.06.2024, në raport me Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore [REDACTED] pas shqyrtimit dhe analizimit të pretendimeve ankimore, unë si autoritet kompetent, nxjerr si në vijim këtë:

### V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e palës: [REDACTED] e paraqitur më datë 18.06.2024, në raport me Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në [REDACTED] lidhur me vendosjen për çështjen disiplinore AD.nr.08/2024 sipas ankesës së palës në fjalë paraqitur kundër prokurorit të shtetit [REDACTED]

### A r s y e t i m

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit - U.D. Kryeprokurori i Shtetit, më datë 20 Qershor 2024, përmes postës ka pranuar nga pala ankuese [REDACTED] ankesën e karakterit disiplinor me dokumentacion shtesë, në raport me Kryeprokurorin e Prokurorisë [REDACTED], për shkak të mospajtit të kësaj pale rreth vendimit refuzues AD.nr.08/2024 të datës 06.06.2024, ku Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në [REDACTED] përmes të njëjtit vendim kishte refuzuar ankesën disiplinore të kësaj pale të datë 15.05.2024, të paraqitur ndaj prokurorit të shtetit [REDACTED], lidhur me çështjen penale: PP.II.2116/23. Kjo palë ankuese përmes të njëjtës ankesë kishte ngritur pretendimet e veta në raport me Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në [REDACTED] duke konsideruar se i njëjti të mos ketë qenë në nivelin e trajtimit objektiv e profesional të ankesës së sipërcekur të karakterit disiplinor.

### Kronologjia e fakteve të rastit:

-Në kontekst të shqyrtimit dhe analizimit të pretendimeve ankimore të parashtruara në ankesën e sipër cekur të palës ankuese në fjalë, Unë si autoritet kompetent, në kuptim të dispozitës së nenit 9 par.1 nënpar.1.4 dhe par.6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (Ligji.nr.06/L-057), kam ndërmarrë veprimet e parashikuara ligjore në raport me Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në [REDAKTUAR], ashtu që sipas shkresës zyrtare: AD.nr.03/2024 të datës 21 Qershor 2024, kam kërkuar nga z. [REDAKTUAR] një raport të detajuar me shkrim rreth ecuresë së trajtimit të çështjes disiplinore ndaj prokurorit të shtetit [REDAKTUAR] AD.nr.08/2024.

Më datë 26 qershor 2024, nga Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në [REDAKTUAR], kam pranuar raportin-njoftimin e detajuar me shkrim rreth ecuresë së trajtimit të asaj çështjeje disiplinore AD.nr.08/2024.

-Pas analizimit dhe shqyrtimit të te gjitha rrethanave faktike të kësaj çështjeje disiplinore e në korrelacion me pretendimet e palës ankuese në fjalë, kam gjetur si në vijim:

-Nga përmbajtja e raportit-njoftimit të sipër cekur me shkrim të Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në [REDAKTUAR], rreth ecuresë së trajtimit të çështjes disiplinore të sipërcekur rezulton se pala ankuese [REDAKTUAR] më datë 27.02.2023. kishte parashtruar kallëzim penal në Prokurorinë Themelore në [REDAKTUAR] si dhe kundër personave përgjegjës të [REDAKTUAR] në drejtim të veprave penale: Cenimi nga marrëdhënia e punës sipas nenit 219 të KPRK-së, Kanosja nga neni 181 i KPRK-së dhe Ngacmimi nga neni 182 i KPRK-së i cili kallëzim penal ishte regjistruar me shenjën e protokollit: PP.II.nr.2116/23 dhe me të njëjtën çështje paraprake penale ishte ngarkuar prokurori i shtetit [REDAKTUAR] i cili me qëllim të verifikimit të pretendimeve në kallëzimin penal, kishte ndërmarrë veprimet e nevojshme procedurale ligjore në mënyrë objektive, të paanshme e profesionale duke përfshirë: ftesën e bërë palës ankuese në fjalë përmes telefonit më datë 24.04.2024 më qëllim të intervistimit në prokurori, mirëpo e njëjta palë nuk ishte paraqitur në prokurori, për çka prokurori i çështjes kishte përpiluar një shënim zyrtar për ftesën dhe mos paraqitjen e kësaj pale. Pala ankuese në fjalë në cilësinë e të dëmtuarit sipas atij kallëzimi penal ishte ftuar edhe me ftesë të rregullt përmes shërbimit postar, ku i njëjti edhe pse ftesën e tillë e kishte pranuar më datë 26.04.2023, i njëjti përsëri nuk ishte paraqitur në prokurori për intervistim si palë e dëmtuar.

Në një gjendje të tillë faktike prokurori i çështjes [REDAKTUAR] në funksion të verifikimit të pretendimeve faktike të palës së dëmtuar në fjalë, më datë 22.02.2024 kishte lëshuar një kërkesë për grumbullimin e informatave të nevojshme drejtuar policisë së Kosovës - Njësitit të Hetimeve të Përgjithshme.

Policia e Kosovës duke vepruar sipas kërkesës së sipërcekur të prokurorit të çështjes, më datë 05.04.2024, kishte dorëzuar në prokurori raportin informues së bashku me provat e mbledhura, duke përfshirë edhe procesverbalet e intervistimit të palës së dëmtuar [REDAKTUAR], si dhe të personave tjerë të përfshirë në të njëjtin kallëzim penal.

Prokurori i shtetit [REDAKTUAR] me rastin e analizimit dhe shqyrtimit të profesional të kallëzimit të tillë penal, si dhe raportit gjithëpërfshirës me provat e grumbulluara nga



Policia e Kosovës, kishte ardhur në përfundimin se nuk ishin konsumuar elementet esenciale të veprave penale të pretenduara nga pala e dëmtuar [REDACTED] dhe më datë 30.04.2024 kishte nxjerrë aktvendim PP.II.nr.2116/2023 për hudhjen e atij kallëzimi penal dhe njëkohësisht sipas detyrimit ligjor kishte njoftuar palën e dëmtuar se në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të atij njoftimi ka të drejtë ankese në Prokurorinë e Apelit të Kosovës.

Pala e dëmtuar në fjalë, në afatin ligjor pranë Prokurorisë së Apelit të Kosovës kishte ushtruar ankese kundër aktvendimit të tillë për hudhje të kallëzimit penal, me ç'rast e njëjta prokurori, sipas aktvendimit: AKAP.II.121/2024 të datës 30.05.2024 kishte refuzuar si të pabazuar ankesën e palës [REDACTED], duke e vërtetuar aktvendimin për hudhje të kallëzimit penal me shenjën: PP.II.2116/2023 të datës 30.04.2024, të nxjerrë nga prokurori i shtetit z. [REDACTED]

Prandaj, pretendimet e palës ankuese [REDACTED], të parashtruara në ankesën e tij disiplinore në raport me Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në [REDACTED] nuk janë të bazuara sepse nga gjendja e fakteve të elaboruara si më lartë, rezulton qartë se subjekti i kësaj ankese, Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në [REDACTED] me asnjë nga veprimet e tija nuk ka kryer ndonjë nga shkeljet e pretenduara të natyrës disiplinore apo profesionale, përkundrazi i njëjti subjekt iu kishte përmbajtur të gjitha kriteret e parashikuara ligjore, profesionale dhe etike në trajtimin e ankesës disiplinore po të kësaj pale ankuese ndaj prokurorit të çështjes [REDACTED]

-Për më tej Kryeprokurori [REDACTED] nuk ka autorizime ligjore që të ndikoj tek një prokuror i shtetit që e ka nën varësi lidhur me aspektet e të vendosurit në një lëndë të caktuar penale, rrethanë kjo e bazuar në nenin 21 par.1 nënpar.1.8 të Ligjit për Prokurorin e Shtetit nr.08/L-167, ku në mënyrë të qartë është parashikuar se “Kryeprokurori mund tu jap udhëzime me shkrim prokurorëve të një prokurorie që udhëheq me qëllim të zbatimit të ligjshmërisë, ngritjes së efikasitetit dhe zbatimit unik të praktikave dhe legjislacionit, mirëpo udhëzimet e tilla duhet të jenë të arsyetuara dhe nuk duhet të cenojnë pavarësinë funksionale dhe profesionale të prokurorëve”. Rrjedhimisht udhëzimet e tilla nënkuptohet se nuk duhet të përmbajnë referime për sa i përket kualifikimit të veprës penale, metodave të hetimit dhe mbledhjes së provave si dhe arsyetimit të hetimit dhe aktakuzës”.

Po ashtu, sipas nenit 8 par.1 nënpar.1.1 të Ligjit për Prokurorin e Shtetit nr.08/L-167, janë përcaktuar detyrat dhe kompetencat e prokurorëve të shtetit ku përfshihet se të njëjtit gjatë “ushtrimit të funksioneve prokuroriale në mënyrë të pavarur, të drejtë, objektive dhe të paanshme të sigurohen që të gjithë personat trajtohen në mënyrë të barabartë para ligjit”.

Andaj, duke u bazuar në atë që u theksua më sipër, konsideroj se pretendimet e palës ankuese [REDACTED] nuk ndërlidhen me asnjë nga rrethanat e parashikuara ligjore, që paraqesin shkelje të natyrës disiplinore dhe për këtë arsye kjo çështje ankimore-disiplinore konsiderohet e mbyllur: A/A.

U.D. Kryeprokurori i Shtetit

Besim Kelmendi